

Nr. regj. 18218/12

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIČE KOVSKA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
Nr. lfaq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
DPE/DMP	03-1008/12
02	06.11.2012
PRISHTINE	

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Burim Qorri nga Drenasi, për kundërvajtje nga neni 16 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Lartë Publik nr. 03/L-151, e në bazë të nenit 73.73.195, 199 si dhe nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 15.10.2012, merre këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Burim Alush Qorri, i lindur më 29.06.1984 në Drenas, ku edhe tani jeton në Drenas, i martuar, Sekretar i pare në Ambasadën e Kosovës në Tiranë, me shkollim superior, i gjendjes së mesme ekonomike, deri tani thotë jo i dënuar.

Është përgjegjës

Sepse me si Zyrtar i lartë Publik, në Pozitë Sekretar i pare në Ambasadën e Kosovës në Tiranë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor me 31.03.2012,

- me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 paragraf 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Lartë Publike, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

QORTIM

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Arsyetim

Agjencinë Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtroi kërkesën nr. 01 1819 të dt. 18.05.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të shënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se si Sekretar i pare në Ambasadën e Kosovës në Tiranë, ka tentuar të dorëzojë formularin për deklarin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit por nuk ka mundur pasi kishte qenë i angazhuar në studime në Slloveni dhe punë në tjera. Me tej shton se me dt. 31 mars 2012 ka bërë përpjekje të dërgoj aplikacionin në Agjencinë kundër Korrupsionit por nuk i ka funksionuar E-maila-adresa, gjithashtu ka tentuar të bisedojë në tel. me Zyrtaret e Agjencisë Kundër Korrupsionit por nuk kishte arritur dhe si dëshmi për përpjekjet e tij ka prezantuar një listë me numra të telefonit me të cilët ka kontaktuar, ku është vërtetuar se ka kontaktuar me Agjencinë Kundër Korrupsionit. Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtari morri në pyetje dëshmitarin Enis Sadikun, Zyrtar në Agjencinë kundër Korrupsionit në Prishtinë, i cili ka deklaruar: se mbetet në tërësi pranë kërkesës për kundërvajtje ndaj të pandehurit, pasi i pandehuri nuk e ka respektuar afatin ligjor për aplikim e pasurisë dhe për të ndihmuar zyrtaret e lartë afatin për deklarin e pasurisë e kemi shtyrë deri me 2 prill 2012, ndërsa i pandehuri Burim Qorri ka deklaruar pasurinë me dt. 05 Prill 2012.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin i deklaratës së të pandehurit, ushtruesit të kërkesës, Zyrtar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe në bazë të dhënave të parashtruara në kërkesë, shqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri, ka bërë kundërvajtje ashtu si e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtor dhe për çka i pandehuri u shpall përgjegjës dhe konform nenit 10 të LMK, i shqiptoi dënim qortimi pasi i pandehuri për herë të parë ka kryer kundërvajtje të tillë, për herë të parë është duke ushtruar një pozitë si zyrtar i lartë, nuk ka shkaktuar

03-4008/12/02
Sung

kurrfarë pasoja, vetëm tri dite është vonuar për te përmbushur obligimin për deklarim te pasurisë, ka ofruar prova materiale me te cilat është vërtetuar përpjekja e tij për ta dorëzuar me kohe aplikacionin mbi deklarimin e pasurisë.

Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK andaj të pandehurit i shqiptoi qortimi mori si rrethanë lehtësuese pasi i pandehuri punon ne Tirane dhe e vetmja mundësi për ta dërguar aplikacionin ne AKK ishte përmes postes elektronike dhe për shkak te mos funksionimit te emali adrese nuk ka arritur ne kohe te përmbush obligimin, gjithashtu si rrethanë lehtësues mori edhe përpjekjet e tija për te kontaktuar me AKK me telefon, Andaj bazuar ne te cekurat si me larte Gjyqtarja i shqiptoi masën e Qorrimit duke llogaritur se edhe me këtë llojë të dënimit te i pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARJA

Lindita Jakupi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit dhe pa taksa.